

cbc IPA programme Cross Border Cooperation

# NA U BASHKËNGJIT!

## në ZHVILLIMIN, PROMOVIMIN DHE PREZANTIMIN e RAJONIT TONË TË BUKUR TË SHARRIT përpara BOTËS

Projekti:
Fuqizimi i turizmit rural dhe mjedisor nëpërmjet Qendrave të Mençura për Informacione / FRET-STIC

European Union 4 Kosovo

Projekti po implementohet nga CeProSARD, RDA South dhe Komuna e Tetovës



European Union Kosovo

‘Kjo broshurë është përpiluar me ndihmën e Bashkimit Evropian në Kosovë. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e CeProSARD dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimet e Bashkimit Evropian në Kosovë.

*‘Vendet anëtare të Bashkimit Evropian kanë vendosur të gërshetojnë shkathtësitë, burimet dhe fatet e veta. Së bashku, ata kanë ndërtuar një zonë stabiliteti, demokracie dhe zhvillimi të qëndrueshëm, duke mirëmbajtur diversitetin kulturor, tolerancën dhe liritë individuale. Bashkimi Evropian zotohet për ndarjen e arritjeve dhe vlerave të veta me vendet dhe popujt përtej kufijve të tij’.*

# RRETH PROJEKTIT FRET-STIC

OBJEKTIVI I PËRGJITHSHËM I PROJEKTIT është zhvillimi, promovimi dhe prezantimi i turizmit lokal dhe rajonal, nëpërmjet të qasjeve dhe sistemeve inovative për një eksperiencë të përmirësuar rurale dhe mjedisore.

OBJEKTIVAT SPECIFIKË janë:

- Themelimi i Qendrave të Mençura për Informacione Turistike - QMIT (STIC) të rrjetëzuara, me kapacitet në grumbullimin, shfrytëzimin dhe krijimin e njohurive mbi potencialet e turizmit në Malin Sharr;
- Kuptimi i rritur dhe prezantimi i potencialeve të turizmit në rajonin ndërkufitar, me përdorim të e-sistemeve bashkëkohore dhe të bashkëpunimit të

## Vendndodhja në Tetovë:
## PK Nr. 1796, Tetovë-1
## Vendndodhja në Prevallë, Prizren:
## P-71813012-02375-12 GORNJE SELLÉ



STIC



GROUND FLOOR, LEVEL ±0,00 M= 1:100



SECTION 1-1 M= 1:100



SECTION 2-2 M= 1:100



FRONT FACADE M= 1:100



SIDE FACADE 1 M= 1:100



## GRUPET QËLLIMORE DHE SHFRYTËZUESIT E FUNDIT

**Grupet kyçe qëllimore dhe shfrytëzuesit e fundit** janë Qendrat për Informacione Turistike, autoritetet lokale, agjencitë e zhvillimit rajonal, agjencitë e turizmit dhe kulturës, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM), klasterët e turizmit, dhomat ekonomike, organizatat civile.

Si lidhen këto mes vete?

- **Qendrat** ekzistuese **për Informacione Turistike** - QIT (TIC) janë avancuar në TIC të Mençura (Smart TIC - STIC) me inkuadrimin e proceseve gjenerike afariste, të cilat mundësojnë shërbim të shtuar ndaj klientëve dhe njëkohësisht grumbullimin e të dhënave me anë të bashkëveprimit njerëzor. Qendrat në rajonin qëllimor rrjetëzohen përmes një Platforme STIC, e cila ofron shërbime informacioni për turistët me anë të një Desku të Automatizuar të Informacioneve (DAI), ose me anë të bashkëveprimit njerëzor. Platforma do të mundësojë shkëmbimin e informacioneve mes STIC në lidhje me preferencat dhe trendet turistike, njëkohësisht duke ushqyer Sistemin e Informacioneve Turistike (SIT) për inteligjencë të rritur afariste.

- **Autoritetet lokale** janë fuqizuar me informacione dhe njohuri për të lehtësuar krijimin e një mjedisi që ofron mundësi për zhvillim të turizmit. Projekti FRET-STIC i furnizon ato me mjete për ndihmimin e subjekteve private duke ndërtuar kështu lidhje të besimit të ndërsjellë dhe pritshmërive realiste. Në fund, numri i shtuar i vizitorëve dhe sektori i fuqizuar i turizmit kontribuon për një zhvillim më të qëndrueshëm, përfshirës dhe të barabartë ekonomik të rajonit.

- **Autoritetet rajonale, agjencitë e turizmit dhe kulturës** ngjashëm me autoritetet lokale pranojnë informacionet e duhura relevante për planifikimin dhe mbështetjen e zhvillimit rajonal. Qenra e Zhvillimit të Rajonit të Pollogut do të përfitojë nga ajo se platformat do të "ushqejnë" Sistemin e tij të Informacioneve Turistike me të dhëna plotësuese relevante. Përfitimi është më se i ndërsjellë, sepse relevanca dhe informacionet që ofrohen përmes SIT rritet me rritjen e të dhënave të ofruara.



- **NVM-të** do të sigurojnë të dhëna të fundit, të gjeneruara përmes SIT dhe Platformës QMIT, në lidhje me kërkesat e përditësuara të turizmit në rajonin ndërkufitar. Ngjashëm me këtë, **bizneset start-up** dhe **sipërmarrësit individual** mund të identifikojnë mundësitë e reja të biznesit. Si të tilla, bizneset private do të jenë në gjendje të ngrisin kapacitetet e veta dhe të angazhohen në mënyrë strategjike në krijimin e produkteve, zgjerimin e tregjeve të tyre dhe do të kontribuojnë për qarkullimin e rritur të bizneseve të tyre.

- **Bizneset, klasterët dhe dhomat** në rajonin ndërkufitar, kanë mundësinë e rrjetëzimit mes vete dhe me subjektet qeverisëse, për të ndërtuar partneritete të reja që çojnë drejt krijimit të nismave të reja, dhe drejt zhvillimit të nismave ekzistuese afariste.

- **Organizatat civile** mund të përfitojnë nga njohuritë e krijuara përmes gjithë këtyre sistemeve, në lidhje me informacionet e vëna në dispozicion për kërkime, transparencë dhe përgatitje të projekteve dhe nismave, të cilat do të ndihmojnë industrinë [e turizmit] dhe shoqërinë në lidhje me një bollëk qëndrimesh, si për shembull, disenjimi i programeve mësimore, barazia gjinore, përfshirja sociale, etj.

**BASHKËNGJITJUNI ZHVILLIMIT, PROMOVIMIT DHE PREZANTIMIT TË RAJONIT TONË TË BUKUR PËRPARA BOTËS**

**Komuna, rajoni, biznesi, organizata, shoqata juaj është pjesë e pashmangshme e gjë-a-gjëzes.**

**E-mail-i: info@rdcpolog.mk**

## REZULTATET E PROJEKTIT

1. Qendra të Mençura për Informacione Turistike të rrjetëzuara, që po zhvillojnë një platformë të ndërsjellë, në bazë të proceseve afariste të standardizuara dhe në bazë të koncepteve ekzistuese të Sistemit të Informacioneve Turistike;

2. Procese afariste të disenjuara për t'u shërbyer në mënyrë efektive dhe efikase turistëve përmes STIC, si dhe grumbullimi i të dhënave mbi sjelljet dhe preferencat e tyre. Stafi i trajnuar në të dy anët e rajonit për të bërë arritje në lidhje me STIC;

3. Matrica e krijuar digjitale mbi infrastrukturën e hartizuar turistike dhe eventeve në Rajonin e Sharrit, duke përfshirë shtegje të shënuara/të pashënuara të këmbësorëve, sinjalizim, vende sistemimi, vende ushqimi, tjera nisma dhe evente. Matrica digjitale do të shfrytëzohet në një Platformë Onlajn Ndër-Rajonale Turistike (iTOP), për të krijuar produkte turizmi për rajonin ndërkufitar;

4. Materiale dhe përmbajtje të krijuara për promovimin e turizmit ndërkufitar të Sharrit;

5. Stafi i trajnuar i TIC për shërbim/grumbullim të mençur të të dhënave mbi turistët, si dhe mbi produktet turistike të krijuara nga matricat.



## AKTIVITETET

Aksioni është disenjuar të korrë potencialin e turizmit ndërkufitar në mënyra inovative. Ai angazhon DY GRUPAZHE aktivitetesh qëndrore, të cilat krijojnë 'përçarje teknologjike'.

**I PARI, në mënyrën se si turistët po informohen dhe si po sillen vendimet në turizmin ndërkufitar.** Përfshin themelimin e qendrave të reja apo të "ridisenjuara" për informacione turistike në QIT (TIC) të reja. Është kjo një qasje nga poshtë lartë dhe përfshin: konsulencën dhe disenjin e platformës së centralizuar - kurrizi i STIC, identifikimi i përshtatjeve të mençura hapësinore për STIC- pozicionet, ndërtimi i hapësirave bazë, shpërndarja e interfejs të shfrytëzuesit dhe kanaleve të komunikimit, trajnimi i vepruesve të inkuadruar për shfrytëzim prapa dhe frontal të sistemit.

**I DYTI, për mënyrën se si disenjohen, si prezantohen dhe si u ofrohen turistëve produktet e turizmit.** Përfshin krijimin e matricës së eventeve dhe platformave të të gjitha llojeve, të cilat pastaj ushqehen dhe integrohen në një Platformë Onlajn Ndër-Rajonale për Turizëm (iTOP).

*Dy grupazhet e sipërpërmendura të aktiviteteve karakterizohen si nën-aktivitete vendimtare dhe komplementare, të nevojitura për rezultatin e suksesshëm të aksionit, si ndërtuese të strategjive përmes konsulencave të gjera dhe koordinimit, dhe zgjerimit të vargjeve të vlerave; dhe si program udhëzimesh për subjektet publike në shfrytëzimin e mjeteve dhe familjarizimi i tyre me, dhe në kuadrin e proceseve afariste.*

## IMPLEMENTIMI I PROJEKTIT ËSHTË ORGANIZUAR NË PESË KLASTERË TË AKTIVITETEVE

### Klasteri i aktiviteteve 1: Themelimi i Qendrave të Mençura për Informacione Turistike - QMIT (STIC) me procese afariste shembuj

- Aktiviteti 1.1 Pozicionimi hapësinor dhe ndërtimi i dy STIC - në Tetovë dhe në Prizren, dhe transformimi i dy TIC në TIC të mençura - në Kodrën e Diellit dhe në Prizren

*Komunat ngrejnë një rrjet të TIC të mençur, që ofron një shërbim të rëndësishëm në komunitet, ofron informacione ose gjëra për të parë dhe bërë, ku të qëndrohet, blihet dhe hahet për vizitorët e Sharrit, që përfshin Rajonin Jugor në Kosovë dhe në Tetovë së bashku me tërë Pollogun e Maqedonisë. Vizitorëve që janë pritur në STIC do t'u shtohet eksperienca e përgjithshme, dhe shpesh do t'i formësojnë perceptimet e tyre për qytetet e vizituara, Sharrin dhe rajonin ndërkufitar në përgjithësi.*

- Aktiviteti 1.2 Krijimi i proceseve të optimizuara gjenerike afariste, që mund të instalohen në cilëndo TIC, pavarësisht nga vendndodhja e saj dhe në çdo kontekst tjetër - mundësojnë shërbim të optimizuar për turistët, me anë të observimit të gjasave për grumbullim të padyshimtë të të dhënave

*Puna e optimizuar e proceseve afariste në DAI (Desqet e Automatizuara të Informacioneve), ose me anë të bashkëveprimit njerëzor, gjegjësisht punonjës në TIC turist. Nga njëra anë ata ofrojnë informacione për klientët (turistët), dhe nga ana tjetër mundësojnë grumbullimin e informacioneve turistike posaçërisht në lidhje me preferencat dhe kërkesat e tyre. Informacionet për servisimin e turistëve ofrohen përmes Platformës STIC, përderisa njëkohësisht sistemi po ushqehet me të dhëna të reja.*





### Klasteri i aktiviteteve 2: Disenjimi i proceseve të standardizuara afariste - dhe i programeve trajnuese - që më mirë të kuptohen dhe shërbehen turistët

- Aktiviteti 2.1 Krijimi i Platformave të STIC është një ueb aplikacion i mëvetësishëm që shfrytëzon proceset afariste të sapokrijuara për grumbullimin e të dhënave mbi preferencat e turistëve, dhe njëkohësisht, për të servisuar kërkesat e turistëve

*STIC ofron dy mënyra të servisimit: përmes bashkëveprimit njerëzor, duke ofruar staf të trajnuar të STIC që do iu përgjigjet kërkesave/do grumbullojë të dhëna me një proces shembull të proceseve afariste; dhe përmes mjeteve elektronike të komunikimit, në formën më të thjeshtë përmes DAI - një kompjuter me prekje, me interfejs intuitiv grafik i cili mundëson vetëshërbimin.*

- Aktiviteti 2.2 Desqet e Automatizuara të Informacioneve (DAI) - platforma të harduerit të instaluara në STIC

*DAI-të janë pikë vetëshërbyese të lehta për përdorim, për turistët që janë vendosur brenda një STIC. Përveç DAI-ve, çdo STIC është ekipuar edhe me stacion pune, të shfrytëzuar nga punonjësit për po të njëjtin qëllim, gjegjësisht, informimin e turistëve.*

- Aktiviteti 2.3 Orë master në servisimin e turistëve - një grup nga 4 mentorë - punonjës publik, mund të trajnojnë të sapopunësuarit që do të punojnë në STIC, ose punonjësit nga komunat tjera brenda rajonit ndërkufitar

*Mentorët me arsimim dhe shkathtësi më të gjerë në psikologji dhe në marketingun e mediave sociale më mirë kuptojnë preferencat e turistëve dhe janë në mundësi që më mirë të disenjojnë strategji marketingu që kanë për qëllim turistët.*

- Aktiviteti 2.4 Programi Trajnues për Servisim të Turistëve për nëpunësit publikë të punësuar në STIC.

*Programet trajnuese për punonjësit e STIC, ofrojnë shërbime edukative mbi: miratimin e proceseve afariste të reja gjenerike në punën ditore, servisimin e turistëve, grumbullimin e të dhënave nga turistë, shfrytëzimin e Platformës STIC, pikat e informimit në rajonin ndërkufitar, psikologjia e shërbimit konsumator.*

**Klasteri i aktiviteteve 3: Hartizimi digjital i infrastrukturës dhe eventeve në lidhje me turizmin rural në rajonin ndërkufitar të Sharrit**

- Aktiviteti 3.1 Hartizimi i potencialeve - infrastruktura dhe eventet / Krijimi i Matricës Digjitale - dhënia e të dhënave për pikat e informacioneve dhe eventeve të të gjitha llojeve: shtegjet, trashëgimia kulturore, sistemimi, vendet e ushqimit, dhe pika tjera me rëndësi, festivale, koncerte, evente tradicionale, etj.

*Matrica shton të dhëna meta rreth ndikimit social, kulturor, ekonomik dhe mjedisor mbi të gjithë këtyre potencialeve për zonat qëllimore ndërkufitare. Produkti dytësor i matricës është sistemi i rëndësisë së koeficientit, matricës është sistemi i rëndësisë së koeficientit, i cili mundëson vlera të caktuara t'i përshkruhen një potenciali, i cili mund të ndryshojë gjatë kohës për të reflektuar relevancën reale, në bazë të inputeve diskrete të klientëve, siç janë rishikimet, vlerësimet, etj.*

*Si e tillë, matrica është një mjet menaxhimi, për një menaxhment të qëndrueshëm të destinacionit, një sistem monitorimi, që mundëson grumbullimin e të dhënave për të monitoruar performancën e çdo pike të informacionit - dhe në përgjithësi - me kalimin e kohës, dhe në fund, një mjet informimi të dobishëm për politikëbërësit, sipërmarrjet turistike dhe vepruesit tjerë.*

*Matrica ka një vizatim vizual dhe mundëson kombinimin e grupazheve të ndryshme të të dhënave, varësisht nga konteksti i shfrytëzimit.*



**Klasteri i aktiviteteve 4: Krijimi i materialeve promotive ndërkufitare për të promovuar aktivitetet dhe rezultatet e projektit**

*Përveç broshurës së projektit, përdoren mjete dhe materiale tjera promotive, siç janë banerë, kartolina, harta turistike, USB me dosje gpx, blogje, foto prezantime, si dhe marketing në mediat sociale.*

*Partnerët e projektit shfrytëzojnë edhe mjetet vetjake të informacioneve (ueb faqe, Facebook, buletine informative), për të komunikuar rregullisht informacione në lidhje me aksionin. Përveç materialeve promotive, vetë STIC mund të konsiderohen si instrumenti më i rëndësishëm për bashkëveprim me vepruesit dhe shfrytëzuesit, si dhe eventet dhe takimet me vepruesit, të organizuara në kuadrin e projektit.*

**Klasteri i aktiviteteve 5: Eventet e përbashkëta ndërkufitare për ndarjen dhe promovimin e rezultateve të aksionit**

- Aktiviteti 5.1 Konferenca Përfundimtare - të informohet publiku për rezultatet e projektit, ndikimin dhe aktivitetet e ardhshme

*Në mesin e audiencës qëllimore përfshihen NVM dhe institucione kërkimore, politikëbërësit dhe vendimsjellësit, klasterët, ekspertët shkencor dhe industrial nëpër të dy vendet. Eventi përfshin distribuimin e materialeve promotive, të përgatitura në kuadrin e projektit.*

- Aktiviteti 5.2 Takimet e konsulencës - të inkurajohet pjesëmarrja aktive e vepruesit kyçë në rajonin e projektit FRET-STIC.

*Katër takime konsulence të organizuara me vepruesit nga të dy vendet gjatë zbatimit të projektit, janë menduar për të komunikuar aktivitetet e planifikuara dhe rezultatet e FRET-STIC, sinergjinë me projektin tjetër në rajon dhe mbi planifikimin e veprimeve të ardhshme me konsideratë të posaçme të fidbekut të marrë nga palët pjesëmarrëse.*








**CeProSARD** është organizatë e shoqërisë civile, e themeluar në vitin 2008, me fokus kryesor të punës në mbrojtjen mjedisore dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Ekipi jonë i profesionistëve në mjedis jetësor, bujqësi, shkencat teknike dhe ekonomi ka njohuri të thelluara dhe eksperiencë në zbatimin e detyrave më komplekse dhe sfiduese në këto fusha. Për më tepër se dhjetë vjet ne punojmë intensivisht në zhvillimin dhe zbatimin e projekteve në nivelin lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, në bashkëpunim të ngushtë me vepruesit kyçë në vend dhe jashtë

**RDA South** është një nga pesë Agjencitë e Zhvillimit Rajonal në Kosovë, të themeluara nga fundi i vitit 2008, me qëllim koordinimi dhe bashkëpunimi mes vepruesve të ndryshëm rajonal drejt zhvillimit të përshpejtuar socio-ekonomik dhe rajonal të rajonit jugor. RDA South mbulon komunat e Prizrenit, Dragashit, Suharekës, Mamushës, Malishevës dhe Rahovecit. Vizioni i saj është "Rajoni Ekonomik i Jugut si zonë ku zhvillimi i qëndrueshëm i planifikuar me strategji, bashkëpunimi dhe partneritetet e suksesshme kanë çuar drejt konkurrueshmërisë së rritur të ekonomisë që bazohet mbi forcat e rajonit dhe mjedisit të favorshëm për investime"..

**Komuna e Tetovës** si komuna më e madhe në Rajonin Planor të Pollogut përbëhet nga 20 lagje të banuara, pothuajse të gjitha rurale. Gjendet në pellgjet qëndrore pjellore dhe dendësisht të banuara të Pollogut dhe kodrat fqinje në rajonin pikturesk perëndimor të Malit Sharr. Qyteti i Tetovës dhe rajoni janë banuar nga disa komunitete etnike dhe historikisht ka shënuar rëndësi të madhe ekonomike dhe strategjike. Rajoni është i njohur me diversitetin e tij të bukurive të mrekullueshme natyrore, karakteristikave kulturore dhe traditave. Qëllimet strategjike të komunës gërshetojnë klimë të përmirësuar afariste, mbështetje dhe zhvilim të turizmit rural, mbrojtje të mjedisit, infrastrukturë të përmirësuar rurale, duke përfshirë njohuritë e shtuara dhe qasjen në informacione në zonat rurale, me anë të rrjetëzimit dhe veprimit të përbashkët të vepruesve relevantë.



*Ky aksion merr përsipër një qasje të inicuar dhe të promovuar nga Qendra e Zhvillimit të Rajonit Planor të Pollogut (QZHRPP) dhe është në sinergji me një numër të aktiviteteve komplementare të inicuara nga Qendra. Rajoni Planor i Pollogut përbëhet nga nëntë komuna (përfshirë këtu dhe Komunën e Tetovës) nga ana e Maqedonisë e rajonit ndërkufitar të Sharrit, duke kontribuar kështu për rëndësinë e aksionit në zonën qëllimore ndërkufitare.*

**Kohëzgjatja e Projektit:**
16 maj 2018  15 maj 2020 (24 muaj)





Projekti po implementohet nga: